



Bazat e Financave Tregtare

Trajnim mbi instrumentet e
financimit të tregtisë



Ky trajnim ka objektiv të mundësojë njohuritë bazë mbi instrumentet më të përdorura të Financave Tregtare si Letër Kreditë, Garancitë Bankare dhe Dokumentet për arkëtim.

Niveli i trajnimit: Mesatar

Gjuha e trajnimit: Shqip

Pjesëmarrja

Anëtar i ICC: 150 EUR

Jo-anëtar: 200 EUR

8-9

SHKURT 2024

Xheko Imperial Hotel

09:00-15:00

REGISTRATION

Qëllimi

Trajnimi do të fokusohet në shpjegimin e karakteristikave kryesore të Instrumenteve dhe Metodave të pagesës më të përdorura në tregtinë ndërkombëtare duke evidentuar risqet, avantazhet dhe disavantazhet e tyre si edhe karakteristikat dhe aspektet thelbësore të instrumentit të Garancisë Bankare.

Fokus grupi

Profesionistë të bankave të nivelit të dytë që janë të angazhuar në produktet dhe shërbimet e ofruara ndaj klientëve të biznesit, punonjës të bizneseve SME apo të mëdha të fokusuar në import/eksport, manaxhere shitjesh/blerjesh apo juristë të rinj pranë zyrave ligjore apo edhe kompanive.

Programi

8 shkurt 2024

>>> Instrumentet dhe Metodat e Pagesës në Tregtinë Ndërkombëtare

- Kuptimi i Financimit të Tregtisë dhe roli i ICC-së.
- Parapagimi e Llogaria e Hapur
- Parimet e Dokumenteve për Arkëtim, palët, funksioni e kostot. Roli i bankave. Përdorimi, përfitimet dhe risqet për importuesin dhe eksportuesin. Praktikrat Uniforme URC 522.
- Parimet e Kredive Dokumentare, tipet, palët, cikli i jetës. Roli i Bankave, financimi dhe kostot kryesore. Përdorimi dhe përfitimet e risqet për importuesin e eksportuesin. Praktikrat Uniforme për Kreditë Dokumentare (UCP)
- INCOTERMs dhe roli i tyre në Tregtinë Ndërkombëtare
- Raste Praktike studimore
- Krahasimi i instrumenteve/metodave të pagesës dhe riskut për importuesin dhe eksportuesin. Pyetje dhe përgjigje

9 shkurt 2024

>>> Garancitë Bankare me Kërkesë

- Garancia dhe përdorimi i saj në tregtinë ndërkombëtare dhe vendase
- Llojet kryesore të Garancive me Kërkesë
- Parimet dhe Struktura e Garancisë, karakteristikat e saj dhe palët. Kundërgarancia e roli i bankave.
- Procesi dhe mënyrat e lëshimit të Garancive me kërkesë, cikli i jetës nga hyrja në fuqi, amendimi, terminimi e anulimi.
- Kërkesa për pagesë, asenjimi dhe transferimi i një Garancie
- Financimi dhe kostot kryesore të një Garancie Bankare
- Rregullat Uniforme të ICC-së për Garancitë me Kërkesë (URDG)
- Ndryshimet thelbësore mes një Garancie Bankare, SBLC-je dhe Kredive Dokumentare
- Raste praktike studimore
- Pyetje dhe përgjigje
- Ndarja e Certifikatave të Pjesëmarrjes

Alda Kriqi (Dautaj)



 [Alda Dautaj_Kriqi](#)

Zj.Kriqi është diplomuar për Financë-Kontabilitet dhe mban diplomë Master në Administrim Biznesi – Profili Sipërmarrje nga Fakulteti i Ekonomisë pranë Universitetit të Tiranës.

Zj.Kriqi ka një eksperiencë mbi 19-vjeçare në sektorin bankar duke punuar gjatë në zhvillimin e instrumenteve e Financimit të Tregtisë si: Letër Kredi, Garanci Bankare, Dokumentet për arkëtim, Faktoring si edhe Financimet e Strukturuara. Ajo zotëron njohuri të thella rreth Rregulloreve Ndërkombëtare të fushës së financimit të tregtisë të publikuara nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë Paris (ICC): UCP 600 e ISPB 745E, URDG 758 e ISDGP, URC 522, Incoterms 2010 e 2020.

Ajo mban Certifikimin e Profesionistit për Financat Tregtare (CTFP 2023-2026) nga ICC Academy.

Alda Kriqi është anëtare pranë Komisionit për Tregtinë Ndërkombëtare, Financimin dhe Investimet të ICC Albania dhe e Komisionit Global të ICC-së për Bankingun që prej vitit 2014. Ajo ka qenë anëtare e grupit të punës për shqipërimin e URDG 758 e INCOTERMS[®]2020. Ajo jep kontribut të vazhdueshëm në çështjet e trajtuara nga komisioni i ICC Albania që nga rishikimi i rregulloreve, udhëzuesve apo Opinioneve teknike që publikohen nga ICC Paris.

Zj. Kriqi drejton Departamentin e Financave Tregtare pranë Raiffeisen Bank sha Albania prej me shumë se 10 vitesh.